LIGJ
Nr.9641, datë 20.11.2006

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË KËSHILLIT TË EUROPËS "PËR PARANDALIMIN E TERRORIZMIT"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet Konventa e Këshillit të Europës "Për parandalimin e terrorizmit", bërë në Varshavë më 16 maj 2005.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5147, datë 12.12.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

KONVENTA
E KËSHILLIT TË EUROPËS PËR PARANDALIMIN E TERRORIZMIT

Varshavë, 16.5.2005
Seria e traktateve europiane ETS nr.196

HYRJE

Vendet anëtare të Këshillit të Europës dhe vendet e tjera nënshkruese të kësaj Konvente:

duke pasur parasysh se qëllimi i Këshillit të Europës është arritja e një uniteti më të ngushtë midis shteteve anëtare të tij;

duke njohur vlerën e bashkëpunimit në rritje me Palët e tjera të kësaj Konvente;

me dëshirën për të marrë masa efektive për parandalimin e terrorizmit dhe në veçanti për përballimin e provokimit publik në lidhje me kryerjen e veprave penale me natyrë terroriste, si dhe rekrutimin dhe trajnimin për qëllime terrorizmin;

të ndërgjegjshme për shqetësimin e thellë të shkaktuar nga përhapja e mëtejshme e veprave penale me natyrë terroriste dhe nga kërcënimi terrorist në rritje;

të ndërgjegjshme për situatën e pasigurt ku ndodhen ata që vuajnë nga terrorizmi dhe, në këtë kontekst, duke rikonfirmuar solidaritetin e tyre të ngushtë me viktimat e terrorizmit dhe të familjeve të tyre;

duke pranuar që veprat penale me natyrë terroriste dhe veprat penale të tjera të parashtruara në këtë Konventë, nga kushdo që të jenë kryer, nuk mund të jenë, nën asnjë rrethanë, të justifikueshme nga asnjë arsye të natyrës politike, filozofike, ideologjike, racore, etnike, fetare apo të ndonjë natyre tjetër të ngjashme dhe duke sjellë në kujtesë detyrimet e të gjitha Palëve për të parandaluar këto vepra penale dhe nëse nuk parandalohen, të ndiqen penalisht dhe të sigurohet që të jenë të ndëshkueshme me dënime, të cilat të marrin në konsideratë natyrën e tyre serioze;

duke sjellë në kujtesë nevojën e forcimit të luftës kundër terrorizmit dhe duke rikonfirmuar që të gjitha masat që merren për parandalimin apo luftimin e veprave penale me natyrës terroriste duhet të respektojnë shtetin ligjor dhe vlerat demokratike, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, si dhe

dispozita të tjera të ligjit ndërkombëtar, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, edhe ligjin humanitar ndërkombëtar;

duke pranuar që kjo Konventë nuk ka si qëllim cenimin e parimeve të pranuara, për sa i përket lirisë së shprehjes dhe lirisë së anëtarësimit në shoqata;

duke sjellë në kujtesë që aktet e terrorizmit synojnë, sipas natyrës ose kontekstit, të kërcënojnë seriozisht një popullatë apo të detyrojnë padrejtësisht një qeveri apo një organizatë ndërkombëtare për kryerjen apo moskryerjen e një veprimi të caktuar, apo destabilizimin ose shkatërrimin e konsiderueshëm të strukturave themelore politike, kushtetuese, ekonomike ose shoqërore të një vendi apo organizate ndërkombëtare,

janë marrë vesh për sa më poshtë vijon:

Neni 1
Termat e përdorur

1. Për qëllime të kësaj Konvente, termi "vepër penale me natyrë terroriste" nënkupton çdo vepër penale brenda fushës së veprimit dhe siç është përkufizuar në një nga traktatet e listuara në shtojcën bashkëlidhur kësaj Konvente.

2. Me depozitimin e instrumenteve të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, një shtet ose Komuniteti Europian, i cili nuk është Palë e një marrëveshjeje të listuar në shtojcën fundore të kësaj Konvente, mund të deklarojë që, në zbatimin e kësaj Konvente nga kjo Palë e interesuar, ajo marrëveshje do të çmohet të mos përfshihet në këtë shtojcë. Ky deklarim do të pushojë së pasuri efekt në kohën që marrëveshja hyn në fuqi për Palën që e bën këtë deklarim, e cila do të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës për këtë hyrje në fuqi.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i kësaj Konvente është intensifikimi i përpjekjeve të Palëve në parandalimin e terrorizmit dhe pasojave të tij negative mbi gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut, në mënyrë të veçantë të drejtën për jetën, nëpërmjet masave të marra si në nivel kombëtar, ashtu edhe në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, duke marrë në konsideratë marrëveshjet ekzistuese dypalëshe dhe shumëpalëshe në fuqi ose marrëveshjet midis Palëve.

Neni 3
Politikat kombëtare të parandalimit

1. Çdo Palë do të marrë masat e nevojshme, veçanërisht në fushën e trajnimit të autoriteteve të zbatimit të ligjit dhe organizmave të tjerë, si dhe në fushën e arsimit, kulturës, informacionit, rritjes së ndërgjegjësimit të mediave dhe publikut, me synim parandalimin e veprave penale me natyrë terroriste dhe pasojave të tyre negative, duke respektuar njëkohësisht detyrimet për të drejtat e njeriut siç janë parashtruar në Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike, si dhe detyrime të tjera nga ligji ndërkombëtar, nëse këto konventa apo marrëveshje janë të zbatueshme për atë Palë.

2. Çdo Palë do të marrë masa të nevojshme për përmirësimin dhe zhvillimin e bashkëpunimit midis autoriteteve kombëtare, me synim parandalimin e veprave penale me natyrë terroriste dhe pasojave të tyre negative, ndër të tjera, nëpërmjet:

a) shkëmbimit të informacionit;

b) përmirësimit të mbrojtjes fizike të personave dhe objekteve;

c) zhvillimit të trajnimit dhe planeve të koordinimit për emergjencat civile.

3. Çdo Palë do të nxisë tolerancë nëpërmjet zhvillimit të mëtejshëm të dialogut ndërfetar dhe mbarëkulturor, duke përfshirë, aty ku është e mundur, organizmat joqeveritarë dhe elemente të tjera të shoqërisë civile, me synim parandalimin e tensioneve që mund të ndikojnë në kryerjen e veprave penale me natyrë terroriste.

4. Çdo Palë do të bëjë përpjekje për nxitjen e ndërgjegjësimit publik për sa i përket ekzistencës, shkaqeve dhe rëndësisë së kërcënimit që vjen nga veprat penale me natyrë terroriste dhe ato të parashtruara në këtë Konventë, si dhe të mbajë në konsideratë nxitjen e publikut për të vënë në dispozicion fakte, ndihmë të veçantë ndaj autoriteteve kompetente që mund të kontribuojnë në parandalimin e veprave penale me natyrë terroriste, si dhe të atyre të parashtruara në këtë Konventë.

Neni 4

Bashkëpunimi ndërkombëtar në lidhje me parandalimin

Sipas rastit dhe në përputhje me kapacitetet e tyre, Palët do të ndihmojnë dhe mbështesin njëra-tjetrën, me synim zhvillimin e kapaciteteve të tyre për parandalimin e kryerjes së veprave penale me natyrë terroriste, me anë të shkëmbimit të informacionit dhe praktikave të tyre më të mira, si dhe me anë të trajnimit dhe përpjekjeve të tjera të përbashkëta të karakterit parandalues.

Neni 5

Provokimi publik për kryerjen e një vepre penale me natyrë terroriste

1. Për qëllime të kësaj Konvente, “provokimi publik për kryerjen e një vepre penale me natyrë terroriste” nënkupton shpërndarjen ose ndryshe vënien në dispozicion të një mesazhi për publikun, me qëllim nxitjes e kryerjes së një vepre penale me natyrë terroriste, ku një sjellje e tillë, megjithëse mund të mos nënkuptojë në mënyrë të drejtpërdrejtë mbështetjen e veprave penale me natyrë terroriste, rrezikon kryerjen e një apo më shumë veprave të tilla.

2. Çdo Palë do të miratojë masa, që çmohen të nevojshme, për ta klasifikuar provokimin publik për kryerjen e veprës penale me natyrë terroriste në ligjet e saj kombëtare si vepër penale të natyrës terroriste, sipas përkufizimit të paragrafit 1 të këtij neni, kur kryhet në mënyrë të paligjshme dhe me dashje.

Neni 6

Rekrutimi për qëllime terrorizmi

1. Për qëllime të kësaj Konvente, “rekrutim për qëllime terrorizmi” nënkupton kërkesën ndaj një personi tjetër për të kryer apo marrë pjesë në kryerjen e një vepre penale me natyrë terroriste ose anëtarësimin në një shoqatë apo grup, me qëllim ndihmën për kryerjen e një apo më shumë veprave penale terroriste nga ana e shoqatës apo e grupit.

2. Çdo Palë do të miratojë masa sipas kushteve të nevojshme, për ta klasifikuar rekrutimin për qëllime terrorizmi në ligjet e saj të brendshme si një vepër penale të natyrës terroriste, sipas përkufizimit të paragrafit 1 të këtij neni, kur kryhet në mënyrë të paligjshme dhe me dashje.

Neni 7

Trajnimi për qëllime terrorizmi

1. Për qëllime të kësaj Konvente, “trajnimi për qëllime terrorizmi” nënkupton dhënien e udhëzimeve për përdorimin e lëndëve eksplozive, armëve të zjarrit ose armëve të tjera apo substancave të dëmshme dhe të rrezikshme, ose të teknikave dhe metodave të tjera të specifike, me synim kryerjen apo ndihmën për kryerjen e një vepre penale me natyrë terroriste, duke pasur dijeni që aftësitë e dhëna synojnë të përdoren për arritjen e këtij qëllimi.

2. Çdo Palë do tí miratojë masat e nevojshme, sipas nevojës, për ta klasifikuar trajnimin për qëllime terrorizmi në ligjet e saj të brendshme si një vepër penale të natyrës terroriste, siç përkufizohet në paragrafin 1 të këtij neni, kur kryhet në mënyrë të paligjshme dhe me dashje.

Neni 8

Papërputhshmëria e kryerjes së një vepre penale me natyrë terroriste

Në mënyrë që një veprim të përbëjë një vepër penale sipas klasifikimit të neneve 5 deri 7 të kësaj Konvente, nuk është e nevojshme që të kryhet një vepër penale me natyrë terroriste.

Neni 9

Veprat penale të ndërvarura

1. Çdo Palë do të miratojë masat e nevojshme për t'i klasifikuar në legjislacionin kombëtar si vepra penale të natyrës terroriste, edhe veprat e mëposhtme:

a) Pjesëmarrjen si bashkëpunëtor në një vepër penale, siç përcaktohet në nenet 5 deri 7 të kësaj Konvente;

b) Organizimin ose urdhërimin e të tjerëve për kryerjen e një vepre penale, siç përcaktohet në nenet nga 5 deri 7 të kësaj Konvente;

c) Në ndihmën për kryerjen e një apo më shumë veprave penale, sipas përcaktimit të neneve 5 deri në 7 të kësaj Konvente, nga një grup personash që veprojnë nën një qëllim të përbashkët, kjo ndihmë do të jetë e qëllimshme, si dhe:

i) do të bëhet me synim zhvillimin e mëtejshëm të veprimtarisë kriminale ose qëllimit kriminal të grupit, ku kjo veprimtari ose qëllim përfshin kryerjen e një vepre penale, siç përcaktohet në nenet 5 deri 7 të kësaj Konvente;

ii) ose do të bëhet në kontekstin e njohjes së qëllimeve të grupit për kryerjen e veprave penale, siç përcaktohet në nenet 5 në 7 të kësaj Konvente.

2. Çdo Palë do të miratojë masat e nevojshme për të klasifikuar si vepër penale në legjislacionin kombëtar tentativën për të kryer një vepër penale, sipas përcaktimit të bërë në nenet 6 dhe 7 të kësaj Konvente.

Neni 10

Përgjegjësitë e subjekteve juridike

1. Çdo Palë do të miratojë masat e nevojshme në përputhje me parimet e saj ligjore, për të vendosur përgjegjësitë e subjekteve juridike për pjesëmarrjen në vepër penale, siç parashikohen në nenet 5 deri 7 dhe 9 të kësaj Konvente.

2. Bazuar në parimet ligjore të secilës Palë, përgjegjësia e subjekteve ligjore mund të jetë penale, civile ose administrative.

3. Kjo përgjegjësi nuk do të cenojë përgjegjësinë penale të personave fizikë që kanë kryer veprat penale.

Neni 11

Sanksionet dhe masat

1. Çdo Palë do të miratojë masat e nevojshme, në mënyrë që veprat penale të përcaktuara në nenet 5 deri në 7 dhe 9 të kësaj Konvente të dënohen nëpërmjet dënimeve efektive, proporcionale dhe bindëse.

2. Dënimet e mëparshme të formës së prerë të dhëna në shtetet e huaja për sa i përket veprave penale të parashikuara në këtë Konventë, mund të merren në konsideratë në masën që e lejon legjislacioni kombëtar, në lidhje me përcaktimin e masës së dënimit në përputhje me legjislacionin kombëtar.

3. Çdo Palë do të sigurojë që subjektet juridike që janë përgjegjëse sipas nenit 10, t'u nënshtrohen sanksioneve penale ose jopenale, efektive, proporcionale dhe bindëse, përfshirë edhe sanksionet financiare.

Neni 12
Kushtet dhe garancitë

1. Çdo Palë do të sigurojë që krijimi, ekzekutimi dhe zbatimi i kriminalizimit sipas neneve 5 deri 7 dhe 9 të kësaj Konvente, të kryhen duke respektuar detyrimet për të drejtat e njeriut, në veçanti të drejtat për lirinë e shprehjes, lirinë e anëtarësimit në shoqata dhe lirinë e fesë, si Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike, si dhe detyrime të tjera nga ligji ndërkombëtar, nëse këto Konventa apo Marrëveshje janë të zbatueshme nga kjo Palë.

2. Për më tepër, krijimi, ekzekutimi dhe zbatimi i kriminalizimit të veprës penale sipas nenit 5 deri në 7, si dhe 9 të kësaj Konvente, duhet t'i nënshtrohet parimeve të proporcionalitetit, për sa u përket qëllimeve legjitime të ndjekura dhe të domosdoshmërisë së tyre në një shoqëri demokratike dhe duhet të përjashtojnë çdo formë arbitrariteti apo trajtim diskriminues ose racist.

Neni 13
Mbrojtja, kompensimi dhe mbështetja ndaj viktimave të terrorizmit

Çdo Palë do të miratojë masat e nevojshme për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të veprave të terrorizmit të kryera brenda territorit të saj. Ndër të tjera, këto masa, bazuar në skema të përshtatshme kombëtare dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar, mund të përfshijnë edhe ndihmë financiare dhe kompensim për viktimat e terrorizmit dhe pjesëtarët të afërm të familjeve të tyre.

Neni 14
Juridiksioni

1. Çdo Palë do të marrë masa legjislative dhe masa të tjera sipas nevojës, për të vendosur juridiksionin mbi çdo vepër penale të përcaktuar sipas kësaj Konvente:

a) kur vepra është kryer në territorin e saj ose

b) kur vepra është kryer në bordin e një anijeje që ngre flamurin e asaj Pale ose në bordin e një avioni të regjistruar sipas ligjeve të asaj Pale; ose

c) kur vepra është kryer nga një prej shtetasve të saj ose nga një person pa shtetësi që ka banesën e tij ose të saj të përhershme në territorin e saj, nëse vepra është e dënueshme sipas së drejtës penale në vendin ku është kryer ose nëse vepra është kryer jashtë juridiksionit territorial të një shteti.

2. Çdo Palë mund të vendosë juridiksionin e vet mbi çdo vepër penale të përcaktuar sipas kësaj Konvente:

a) kur vepra synohej ose rezultonte në kryerjen e një vepre penale të referuar në nenin 1 të kësaj Konvente në territorin ose kundër një shtetasi të asaj Pale;

b) kur vepra synohej ose rezultonte në kryerjen e një vepre penale të referuar në nenin 1 të kësaj Konvente kundër një objekti shtetëror ose qeveritar të asaj Pale jashtë vendit, duke përfshirë edhe ambientet e godinave konsullore dhe diplomatike të asaj Pale; ose

c) kur vepra synohej ose rezultonte në kryerjen e një vepre penale të referuar në nenin 1 të kësaj Konvente, e kryer me tentativën për të detyruar atë Palë në kryerjen ose frenimin e kryerjes së ndonjë veprimi; ose

d) kur vepra është kryer nga një person pa shtetësi që ka banesën e tij ose të saj të përhershme në territorin e saj; ose

e) kur vepra është kryer në bordin e një avioni, i cili operohet nga qeveria e asaj Pale.

3. Çdo Palë do të miratojë masa sipas nevojës për të vendosur juridiksion mbi veprat penale të referuara në këtë Konventë, në rastet kur një shkelës i dyshuar është i pranishëm në territorin e saj dhe pas një kërkese për ekstradim, nuk e ekstradon atë te një Palë tjetër, juridiksioni i së cilës mbështetet në të njëjtin juridiksion ligjor si ai i Palës, së cilës i kërkohet ekstradimi.

4. Kjo Konventë nuk përjashton juridiksionin penal të ushtruar nga një Palë, në përputhje me legjislacionin e brendshëm.

5. Kur më shumë se një Palë kërkon juridiksion mbi një vepër penale të dyshuar të përcaktuar sipas kësaj Konvente, Palët e përfshira do të konsultohen, sipas nevojës, me qëllim vendosjen e juridiksionit më të përshtatshëm për ndjekjen penale.

Neni 15
Detyra për të hetuar

1. Me marrjen e njoftimit që një person, i cili ka kryer ose supozohet të ketë kryer një vepër penale të parashikuar nga kjo Konventë, mund të ndodhet në territorin e saj, Pala e interesuar do të marrë masat e nevojshme sipas legjislacionit të brendshëm për të hetuar faktet që përmban ky informacion.

2. Me bindjen se rrethanat e kërkojnë këtë, Pala në territorin e së cilës krimineli ose personi i dyshuar si kriminel është i pranishëm në territorin e saj, do të marrë masat e nevojshme në përputhje me legjislacionin e brendshëm, në mënyrë që të sigurojë praninë e atij personi për ndjekje penale apo ekstradim.

3. Çdo personi, ndaj të cilit janë marrë masat që parashikohen në paragrafin 2, do t'i jepet e drejta:

a) për të komunikuar pa vonesë me përfaqësuesin më të afërt të shtetit, shtetas i të cilit ai është ose të atij shteti që i jepet e drejta për të mbrojtur të drejtat e tij ose nëse ai person është pa shtetësi, me shtetin në territorin e të cilit ky person ka banesën e përhershme;

b) për t'u vizituar nga një përfaqësues i atij shteti;

c) për t'u informuar për të drejtat e atij personi sipas nënparagrafit a dhe b.

4. Të drejtat që referohen mbi bazën e paragrafit 3 do të ushtrohen në përputhje me ligjet dhe rregulloret e Palës, në territorin e së cilës autori i veprës penale ose personi i dyshuar si i tillë është i pranishëm, duke iu nënshtruar dispozitës se ligjet dhe rregulloret e sipërpërmendura duhet të kenë efekt të plotë ndaj qëllimeve për të cilat synohen të drejtat e dhëna sipas paragrafit 3.

5. Dispozitat e paragrafëve 3 dhe 4 nuk do të cenojnë të drejtën e asnjë Pale që ka një kërkesë juridiksioni në përputhje me nenin 14, paragrafët 1.d dhe 2.d, për të ftuar Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq për të komunikuar me personin e supozuar për kryerjen e veprës penale dhe për ta vizituar atë.

Neni 16
Moszbatimi i Konventës

Kjo Konventë nuk zbatohet kur një vepër penale e përcaktuar në përputhje me nenet 5 deri 7, si dhe 9 është kryer brenda një shteti të vetëm, kur personi i dyshuar për veprën penale është shtetas i atij vendi dhe është i pranishëm në territorin e atij shteti, dhe asnjë shtet tjetër nuk bazohet në nenin 14, paragrafi 1 ose 2, të kësaj Konvente, për të ushtruar juridiksion, duke nënkuptuar që dispozitat e nenit 17 dhe ato të neneve 20 deri 22 të kësaj Konvente do të zbatohen sipas nevojës në këto raste.

Neni 17
Bashkëpunimi ndërkombëtar për çështje penale

1. Palët do t'i japin njëra-tjetrës ndihmën maksimale në lidhje me hetimet ose procedurat penale dhe ato të ekstradimit, për sa i përket veprave penale të parashtruara në nenet 5 dhe 7 të kësaj Konvente, duke përfshirë edhe ndihmën në gjetjen e provave që mund të kenë në dispozicion, të nevojshme për procedimin e këtyre veprave penale.

2. Palët do të përmbushin detyrimet e tyre të paragrafit 1, në përputhje me çdo traktat ose marrëveshje tjetër mbi ndihmën e ndërsjellë juridike që mund të ekzistojë midis tyre. Në mungesë të këtyre traktateve apo marrëveshjeve, Palët do ta ndihmojnë njëra- tjetrën, në përputhje me legjislacionin kombëtar.

3. Palët do të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën në nivelin maksimal të mundshëm mbi bazën e ligjit përkatës, traktateve, marrëveshjeve apo rregullimeve të tjera ligjore të Palës së kërkuar, për sa i përket hetimit penal apo procedimeve në lidhje me veprat penale për të cilat një person juridik mund të jetë përgjegjës në përputhje me nenin 10 të kësaj Konvente, në Palën kërkuese.

4. Çdo Palë mund të shqyrtojë krijimin e mekanizmave shtesë për të shkëmbyer me Palët e tjera informacion ose prova që, në zbatim të nenit 10, nevojiten për vendosjen e përgjegjësisë penale, civile apo administrative.

Neni 18
Ekstradimi ose ndjekja penale

1. Pala, në territorin e së cilës është i pranishëm personi që dyshohet të ketë kryer veprën penale, kur ka juridiksion në përputhje me nenin 14, nëse nuk e ekstradon atë person, pa asnjë lloj përjashtimi dhe nëse vepra penale është kryer ose jo në territorin e saj, do të jetë e detyruar t'ua paraqesë çështjen penale autoriteteve kompetente pa asnjë vonesë të pajustifikueshme, me qëllim ndjekjen penale nëpërmjet procedurave që janë në përputhje me legjislacionin e atij vendi. Ato autoritete kompetente duhet të marrin vendimet e tyre në të njëjtën mënyrë si në rastin e çdo vepre tjetër të rëndë penale, sipas legjislacionit të asaj Pale.

2. Sa herë që një Palë i lejohet nga legjislacioni i saj i brendshëm të ekstradojë apo edhe të dorëzojë një shtetas të saj me kusht që personi do t'i rikthehet asaj Pale për të vuajtur dënimin e dhënë si rezultat i procesit gjyqësor apo i procedimit penal për të cilin ekstradimi apo dorëzimi i personit është kërkuar, dhe kjo Palë si dhe Pala tjetër që ka kërkuar ekstradimin e personit bien dakord me këtë zgjedhje dhe me kushte të tjera që mund të çmohen të nevojshme, një ekstradim i tillë i kushtëzuar apo dorëzim i personit do të jenë të mjaftueshëm për çlirimin nga detyrimi që parashikohet në paragrafin 1.

Neni 19
Ekstradimi

1. Veprat penale të parashtruara në nenin 5 deri në 7 dhe 9 të kësaj Konvente do të çmohen si të përfshira në veprat penale të ekstradueshme në çdo marrëveshje ekstradimi që mund të ekzistojë midis secilës prej Palëve, para hyrjes në fuqi të kësaj Konvente. Palët do të marrin masat e nevojshme për përcaktimin e këtyre veprave penale si vepra penale të ekstradueshme në çdo marrëveshje ekstradimi që mund të bëhet më pas midis tyre.

2. Kur një Palë, e cila bën ekstradim të kushtëzuar në bazë të një marrëveshjeje, merr një kërkesë ekstradimi nga një Palë tjetër, me të cilën ajo nuk ka marrëveshje ekstradimi, atëherë Pala e kërkuar, mbi bazën e vendimit që merr, mund ta konsiderojë këtë Konventë si bazë ligjore për ekstradim në lidhje me veprat penale që parashikohen në nenet 5 deri në 7 dhe 9 të kësaj Konvente. Ekstradimi do t'u nënshtrohet kushteve të tjera, të cilat parashikohen nga ligji i Palës së kërkuar.

3. Palët që nuk bëjnë ekstradim të kushtëzuar mbi bazën e një marrëveshjeje, do t'i njohin veprat penale të parashikuara në nenet 5 deri 7 dhe 9 të kësaj Konvente si vepra penale të ekstradueshme midis tyre, duke iu nënshtruar kushteve të parashikuara nga ligji i Palës së kërkuar.

4. Kur është e nevojshme, për qëllime ekstradimi midis Palëve, veprat penale të parashikuara në nenet 5 deri në 7 dhe 9 të kësaj Konvente, do të trajtohen sikur të mos jenë kryer vetëm në vendin ku ato kanë ndodhur, por edhe në territoret e Palëve, të cilat e kanë miratuar juridiksionin në përputhje me nenin 14.

5. Dispozitat e të gjitha traktateve dhe marrëveshjeve të ekstradimit të hartuara midis Palëve në lidhje me veprat penale të parashikuara në nenet nga 5 deri në 7, si dhe 9 të kësaj Konvente, do të çmohen si të modifikuara midis Palëve në masën që ato janë të papajtueshme me këtë Konventë.

Neni 20
Përcaktimi i klauzolës së përjashtimit politik

1. Asnjë prej veprave penale që referohen në nenet 5 deri në 7, si dhe 9 të kësaj Konvente, për qëllime ekstradimi ose ndihme të ndërsjellë juridike, nuk do të çmohet si një vepër penale politike, si krim i lidhur me një vepër penale politike ose si vepër penale e shtyrë nga motive politike. Për rrjedhojë, një kërkesë për ekstradim ose për ndihmë të ndërsjellë juridike, e bazuar në një vepër të tillë penale, mund të mos refuzohet për arsyen e vetme se ka lidhje me një vepër penale politike ose me një krim të lidhur me një vepër penale politike apo me një vepër penale të shtyrë nga motive politike.

2. Pa cenuar zbatimin e neneve 19 deri 23 të Konventës së Vjenës mbi Ligjin e Marrëveshjeve, të 23 majit 1969 ndaj neneve të tjera të kësaj Konvente, çdo shtet ose Komuniteti Europian, në kohën e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në Konventë, mund të deklarojë se rezervon të drejtën e moszbatimit të paragrafit 1 të këtij neni për sa i përket ekstradimit për një vepër penale të parashtruar në këtë Konventë. Pala ndërmerr të zbatojë këtë rezervë rast pas rasti, nëpërmjet një vendimi të mirarsyetuar.

3. Në përputhje me paragrafin 2, çdo Palë mund të bëjë një rezervë, pjesërisht apo tërësisht, nëpërmjet një deklarimi të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, i cili hyn në fuqi në datën e konfirmimit të marrjes së tij.

4. Një Palë e cila ka bërë rezervë në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, mund të mos kërkojë zbatimin e paragrafit 1 të këtij neni nga çdo Palë tjetër; por bazuar në faktin nëse rezerva e saj është e pjesshme apo e plotë, mund të kërkojë zbatimin e këtij neni për atë pjesë të cilën e ka pranuar vetë.

5. Për sa i përket Palës së interesuar, rezerva do të jetë e vlefshme për një periudhë trevjeçare nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente. Megjithatë, kjo rezervë mund të rinovohet për periudha me kohëzgjatje të njëjtë.

6. Dymbëdhjetë muaj para datës së përfundimit të rezervës, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të njoftojë Palën e interesuar në lidhje me mbarimin e afatit. Jo më vonë se tre muaj para datës së mbarimit të afatit, Pala e interesuar do të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës nëse ajo do të mbështesë, amendojë apo tërheqë rezervën e saj. Kur një Palë njofton Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës që mbështet rezervën e saj, ajo duhet të japë një sqarim në lidhje me arsyet që argumentojnë vazhdimin e rezervës. Në mungesë të njoftimit nga Pala e interesuar, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të informojë atë Palë që rezerva e saj konsiderohet automatikisht e shtyrë për një periudhë gjashtëmujore. Mungesa e mëtejshme e njoftimit nga ana e Palës së interesuar për qëllimet e saj për të mbështetur apo modifikuar rezervën e saj para mbarimit të kësaj periudhe, çon në mbarimin e afatit të rezervës.

7. Kur një Palë nuk ekstradon një person në zbatim të kësaj rezerve, pas marrjes së një kërkese ekstradimi nga një Palë tjetër, ajo duhet t'ua paraqesë këtë çështje penale autoriteteve kompetente, pa asnjë lloj përjashtimi dhe pa asnjë vonesë të paargumentuar, me qëllim ndjekjen penale, përveçse në rastet kur Pala kërkuese dhe Pala e kërkuar bien dakord ndryshe. Për qëllime të ndjekjes penale në Palën e kërkuar, autoritetet kompetente do t'i marrin vendimet e tyre në të njëjtën mënyrë si në rastin e çdo vepre të rëndë penale, sipas legjislacionit të asaj Pale. Pala e kërkuar do ta komunikojë, pa vonesa të pajustifikueshme, rezultatin përfundimtar të procedimit penal Palës kërkuese dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, i cili e paraqet atë më tej për t'iu nënshtruar konsultimit së Palëve, siç parashikohet në nenin 30.

8. Vendimi për të refuzuar një kërkesë ekstradimi, mbi bazën e kësaj rezerve, do t'i paraqitet menjëherë Palës kërkuese. Nëse brenda një kohe të arsyeshme, nuk është arritur asnjë vendim gjyqësor në themel në Palën e kërkuar për çështjen në fjalë, sipas paragrafit 7 , Pala kërkuese mund t'ia komunikojë këtë fakt Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, i cili mund t'ia paraqesë këtë çështje më tej për t'iu nënshtruar konsultimit të Palëve, siç parashikohet në nenin 30. Ky konsultim do të marrë në konsideratë çështjen dhe do të japë një mendim në lidhje me pajtueshmërinë e refuzimit me Konventën dhe do t'ia paraqesë atë Komitetit të Ministrave, me qëllim lëshimin të një deklarate në përputhje me atë mendim. Gjatë kryerjes së funksioneve sipas këtij paragrafi, Komiteti i Ministrave do të mblidhet me përbërje të kufizuar vetëm nga Shtetet Palë.

Neni 21

Çështja e diskriminimit

1. Asgjë në këtë Konventë nuk do të interpretohet si vendosje e një detyrimi për ekstradim apo i ndihmës së ndërsjellë juridike, nëse Pala e kërkuar ka arsye të forta për të besuar se kërkesa për ekstradim për vepra penale të parashikuara në nenet 5 deri në 7 dhe 9 ose ndihma e ndërsjellë juridike në lidhje me vepra penale të kësaj natyre është bërë me qëllimin e ndjekjes penale dhe dënimit të një personi për arsye të lidhura me racën, fenë, kombësinë, origjinën etnike apo opinionet politike të tij, ose zbatimi i kërkesës mund të cenojë pozicionin e atij personi për ndonjë prej arsyeve të mësipërme.

2. Asgjë në këtë Konventë nuk do të interpretohet si vendosje e një detyrimi për ekstradim,

nëse personi për të cilin është bërë kërkesa për ekstradim rrezikon t'i nënshtrohet torturës ose dënimit dhe trajtimit çnjerëzor degradues.

3. Asgjë në këtë Konventë nuk do të interpretohet si vendosje e një detyrimi për ekstradim, nëse personi për të cilin është bërë kërkesa për ekstradim, rrezikon t'i nënshtrohet dënimit me vdekje ose kur ligji i Palës së kërkuar nuk merr parasysh dënimin me burgim të përjetshëm, si dhe të burgimit të përjetshëm pa mundësinë e lirimit të përkohshëm me kusht, përveçse në rastet kur në kushtet e marrëveshjeve ekzistuese të ekstradimit, Pala e kërkuar ndodhet nën detyrimin e ekstradimit nëse Pala kërkuese jep garanci që çmohen të mjaftueshme nga Pala e kërkuar që dënimi me vdekje nuk do të zbatohet, ose nëse do të zbatohet, nuk do të kryhet, ose që personi në fjalë nuk do të dënohet me burgim të përjetshëm pa iu dhënë mundësia e lirimit të përkohshëm me kusht.

Neni 22
Informacionet spontane

1. Pa cenuar hetimet dhe procedimet penale të tyre, autoritetet kompetente të një Pale, pa ndonjë kërkesë paraprake, mund t'i dërgojnë informacion autoriteteve përkatëse të një Pale tjetër që mund të jetë mbledhur në kuadrin e hetimit të bërë nga kjo Palë dhe kur çmohet se vënia në dispozicion e këtij informacioni mund ta ndihmojë Palën që merr informacionin në lidhje me fillimin ose kryerjen e hetimit apo të procedimit penal, ose që mund të çojë në bërjen e një kërkese nga kjo Palë mbi bazën e dispozitave të kësaj Konvente.

2. Pala që vë në dispozicion informacionin, në zbatim të legjislacionit të saj të brendshëm, mund të vendosë kushte mbi përdorimin e një informacioni të tillë nga ana e Palës që merr informacionin.

3. Pala që merr informacionin do të respektojë kushtet e vëna nga Pala që vë në dispozicion këtë informacion.

4. Megjithatë, çdo Palë, në çdo kohë, nëpërmjet një deklarate të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund të deklarojë që rezervon të drejtën për të mos respektuar kushtet e vendosura nga Pala që ka vënë në dispozicion informacionin mbi bazën e paragrafit 2 më sipër, përveçse në rastet kur ajo merr njoftim paraprak mbi natyrën e informacionit që vihet në dispozicion dhe bie dakord me dërgimin e tij.

Neni 23
Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim për Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës dhe për shtetet joanëtare që kanë marrë pjesë në hartimin e saj.

2. Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

3. Kjo Konventë hyn në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore pas datës kur gjashtë shtete nënshkruese, nga të cilat të paktën katër janë shtete anëtare të Këshillit të Europës kanë shprehur pëlqimin e tyre për të respektuar këtë Konventë, në përputhje me dispozitat e paragrafit 2.

4. Për çdo shtet nënshkrues që do të shprehë më pas pëlqimin e vet për të respektuar këtë Konventë, kjo do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore pas datës së shprehjes së pëlqimit për ta respektuar Konventën në përputhje me dispozitat e paragrafit 2.

Neni 24
Aderimi në Konventë

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës, pas konsultimit me Shtetet Palë të Konventës dhe miratimit të tyre unanim, mund të ftojë çdo shtet joanëtar të Këshillit të Europës, i cili nuk ka marrë pjesë në hartimin e kësaj Konvente, për të aderuar në këtë Konventë me anë të një vendimi që merret me shumicën e parashikuar në nenin 20.d të Statutit të Këshillit të Europës dhe me unanimitetin e përfaqësuesve të Shteteve Palë që gëzojnë të drejtën e anëtarit të Komitetit të Ministrave.

2. Për çdo shtet aderues në Konventë, në përputhje me paragrafin 1 më sipër, Konventa do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore pas datës së depozitimit të instrumentit të aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 25
Zbatimi territorial

1. Çdo shtet, në kohën e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, mund të përcaktojë territorin ose territoret ku do të zbatohet kjo Konventë.

2. Çdo shtet, në çdo datë tjetër të mëvonshme, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund të shtrijë zbatimin e kësaj Konvente në çdo territor tjetër të përcaktuar në deklaratë. Konventa do të hyjë në fuqi për këtë territor ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore pas datës së marrjes së deklaratës nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

3. Çdo deklaratë, në lidhje me ndonjë territor të përcaktuar në deklaratë, e bërë në bazë të dy paragrafëve paraardhës, mund të tërhiqet me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Tërheqja do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore, pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 26
Efektet e Konventës

1. Kjo Konventë shërben si shtesë e traktateve dhe marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe në fuqi midis Palëve, duke përfshirë dhe dispozitat e traktateve të mëposhtme të Këshillit të Europës:

- Konventa europiane mbi ekstradimin, e hapur për nënshkrim në Paris, më 13 dhjetor 1957 (ETS nr.24).
- Konventa europiane mbi ndihmën e ndërsjellë në çështjet penale, e hapur për nënshkrim, në Strasburg, më 20 prill 1959 (ETS nr. 30).
- Konventa europiane mbi luftën kundër terrorizmit, e hapur për nënshkrim, në Strasburg, më 27 janar 1977 (ETS nr.90).
- Protokolli shtesë i konventës europiane mbi ndihmën e ndërsjellë në çështjet penale, i hapur për nënshkrim, në Strasburg, më 17 mars 1978 (ETS nr.99).
- Protokolli i dytë shtesë i konventës europiane mbi ndihmën e ndërsjellë në çështjet penale, i hapur për nënshkrim, në Strasburg, më 8 nëntor 2001 (ETS nr.182).
- Protokolli që amendon konventën europiane mbi luftën kundër terrorizmit, i hapur për nënshkrim në Strasburg, më 15 maj 2003 (ETS nr.190).

2. Nëse dy ose më shumë Palë kanë lidhur një marrëveshje apo traktat mbi çështjet e trajtuara në këtë Konventë, kanë krijuar marrëdhënie të tjera mbi këto çështje apo parashikojnë ta bëjnë një gjë të tillë në të ardhmen, do të jenë të autorizuara të zbatojnë atë marrëveshje ose traktat apo të rregullojnë marrëdhëniet e tyre në përputhje me atë qëllim. Megjithatë, kur Palët krijojnë marrëdhëniet e tyre në lidhje me çështjet e trajtuara në këtë Konventë, ndryshe nga ato që janë trajtuar në të, do t'i rregullojnë këto çështje në mënyrë të tillë që të mos bien ndesh me parimet dhe objektivat e kësaj Konvente.

3. Palët të cilat janë anëtare të Bashkimit Europian, në marrëdhëniet e tyre të ndërsjella, do të zbatojnë rregulloret e Komunitetit dhe Bashkimit Europian për sa kohë që ka në fuqi rregullore të Komunitetit dhe të Bashkimit Europian që rregullojnë çështje të interesit specifik dhe të zbatueshme për çdo rast të veçantë, pa cenuar objektin dhe qëllimin e kësaj Konvente dhe pa cenuar zbatimin e plotë të saj ndaj Palëve të tjera.

4. Asgjë në këtë Konventë nuk do të ketë efekte mbi të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e tjera të një Pale apo të individëve, të parashikuara në legjislacionin ndërkombëtar, përfshirë këtu edhe ligjin humanitar ndërkombëtar.

5. Veprimtaritë e Forcave të Armatosura gjatë një konflikti të armatosur, siç ato terma kuptohen sipas ligjit humanitar ndërkombëtar dhe që rregullohen nga ai ligj, nuk rregullohen nga kjo

Konventë dhe veprimtaritë e ndërmarra nga forcat ushtarake të një Pale në ushtrimin e detyrave të tyre zyrtare, në shkallën që ato rregullohen nga rregullore të tjera të ligjit ndërkombëtar, nuk rregullohen nga kjo Konventë.

Neni 27
Amendamentet ndaj Konventës

1. Amendamentet ndaj kësaj Konvente mund të propozohen nga çdo Palë, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës ose Konsultimi ndërmjet Palëve.

2. Çdo propozim për amendament do t'u komunikohet Shteteve Palë të kësaj Konvente nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

3. Për më tepër, amendamenti i propozuar nga një Palë ose Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës i komunikohet Grupit Konsultues ndërmjet Palëve, i cili i paraqet Komitetit të Ministrave mendimin e vet për amendamentin e propozuar.

4. Komiteti i Ministrave do të shqyrtojë amendamentin e propozuar dhe mendimin e paraqitur nga Grupi Konsultues ndërmjet Palëve dhe mund të miratojë amendamentin në fjalë.

5. Teksti i çdo amendamenti të miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni do t'u transmetohet Palëve për pranim.

6. Çdo amendament i miratuar në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni, do të hyjë në fuqi ditën e tridhjetë pasi të gjitha Palët të kenë informuar Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës se e kanë pranuar atë.

Neni 28
Rishikimi i shtojcës

1. Me qëllim përditësimin e listës së traktateve në shtojcën bashkëlidhur, mund të propozohen amendime nga secila Palë ose nga Komiteti i Ministrave. Këto propozime për amendime do të përfshijnë vetëm marrëveshjet universale të lidhura brenda sistemit të Kombeve të Bashkuara që merren kryesisht me terrorizmin ndërkombëtar dhe që kanë hyrë në fuqi. Ato do t'u komunikohen Palëve nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

2. Pas konsultimit me Palët joanëtare, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Europës mund të miratojë një amendim të propozuar nga shumica, siç parashikohet në nenin 20 pika "d" të Statutit të Këshillit të Europës. Amendimi do të hyjë në fuqi në vijim të përfundimit të periudhës prej 1 viti nga data që ai u është dërguar Palëve. Gjatë kësaj periudhe, çdo Palë mund të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës për kundërshtime të mundshme për hyrjen në fuqi të atij amendimi në lidhje me atë Palë.

3. Nëse një e treta e Palëve e njofton Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës mbi një kundërshtim për hyrjen në fuqi të amendimit, ky i fundit nuk do të hyjë në fuqi.

4. Nëse më pak se një e treta e Palëve njoftojnë në lidhje me një kundërshtim, amendimi do të hyjë në fuqi për ato Palë, të cilat nuk kanë bërë njoftim për atë kundërshtim.

5. Kur amendimi ka hyrë në fuqi në përputhje me paragrafin 2 dhe një Palë ka shprehur kundërshtim për atë amendim, atëherë ky amendim do të hyjë në fuqi për sa i përket Palës në fjalë e cila nuk e ka pranuar atë, në ditën e parë të muajit, në vijim të datës në të cilën ajo Palë njofton Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës për pranimin e tij.

Neni 29
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rastin e një mosmarrëveshjeje midis dy ose më shumë Palëve përsa i përket interpretimit ose zbatimit të kësaj Konvente, Palët në fjalë do të përpiqen të zgjidhin mosmarrëveshjet nëpërmjet bisedimit ose çdo zgjidhjeje tjetër paqësore sipas zgjedhjes së tyre, përfshirë këtu paraqitjen e mosmarrëveshjes para një gjykate arbitrazhi, vendimet e së cilës do të jenë të detyrueshme për Palët ose paraqitjen e mosmarrëveshjes para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë siç mund të bihet dakord

nga Palët në fjalë.

Neni 30
Konsultimi ndërmjet Palëve

1. Palët do të konsultohen në mënyrë periodike me synim:

a) bërjen e propozimeve për të lehtësuar ose përmirësuar përdorimin efektiv dhe zbatimin e kësaj Konvente, duke përfshirë identifikimin e çdo problemi dhe efektet e çdo deklarimi të bërë në kuadrin e kësaj Konvente;

b) formulimin e opinionit mbi pajtueshmërinë e një refuzimi për të ekstraduar, i cili u referohet atyre në përputhje me nenin 20 paragrafi 8;

c) bërjen e propozimeve për amendimin e kësaj Konvente në përputhje me nenin 27;

d) formulimin e opinionit mbi çdo propozim për amendimin e kësaj Konvente, i cili i referohet atyre në përputhje me nenin 27 paragrafi 3;

e) shprehjen e një opinioni mbi çdo çështje që i përket zbatimit të kësaj Konvente dhe lehtësimin e shkëmbimit të informacionit mbi zhvillime të ndjeshme në fushën ligjore, politike apo teknologjike.

2. Konsultimet e Palëve do të bëhen nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës kurdoherë që ai e çmon të nevojshme dhe në çdo rast, kur një shumicë e Palëve ose e Komitetit të Ministrave kërkon mbledhjen e tij.

3. Palët do të asistohen nga Sekretariati i Këshillit të Europës gjatë kryerjes së funksioneve të tyre në zbatim të këtij neni.

Neni 31
Denoncimi

1. Çdo Palë mund ta denoncojë këtë Konventë në çdo kohë, duke i drejtuar një njoftim Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Denoncimi do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 32
Njoftimet

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të njoftojë Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës, çdo shtet që ka nënshkruar këtë Konventë, çdo Shtet Palë, Komunitetin Europian, çdo shtet që është ftuar ta nënshkruajë këtë Konventë, si dhe çdo shtet që është ftuar të aderojë në këtë Konventë në lidhje me:

a) çdo nënshkrim;

b) depozitimin e instrumenteve të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit;

c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, në përputhje me dispozitat e nenit 23 të saj;

d) çdo deklaratë të bërë në përputhje me dispozitat e nenit 1 paragrafi 2, nenit 22 paragrafi 4 dhe nenit 25;

e) çdo akt tjetër, njoftim ose komunikim që ka të bëjë me këtë Konventë.

Në dëshmi të sa më sipër, nënshkruesit, të autorizuar posaçërisht për këtë qëllim, kanë firmosur këtë Konventë.

Bërë në Varshavë, më 16 maj 2005, në një origjinal të vetëm në gjuhët frënge dhe angleze, të dyja tekstet njëlloj të besueshme, që do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'u dërgojë një kopje të vërtetuar secilit prej Shteteve Anëtare të Këshillit të Europës, Komunitetit Europian, shteteve joanëtare që kanë marrë pjesë në hartimin e Konventës, si dhe çdo shteti tjetër të ftuar për të aderuar në të.

SHTOJCA

1. Konventa për ndalimin e sekuestrimit të paligjshëm të avionëve, nënshkruar në Hagë, më 16 dhjetor 1970.

2. Konventa për ndalimin e akteve të paligjshme ndaj sigurisë së aviacionit civil, e lidhur në Montreal, më 23 shtator 1971.

3. Konventa për parandalimin dhe ndëshkimin e veprave penale ndaj personave të mbrojtur në nivel ndërkombëtar, përfshirë agjentët diplomatikë, e miratuar në Nju-Jork, më 14 dhjetor 1973.

4. Konventa ndërkombëtare kundër marrjes së pengjeve, e miratuar në Nju-Jork, më 17 dhjetor 1979.

5. Konventa për mbrojtjen fizike të materialeve bërthamore, e miratuar në Vjenë, më 3 mars 1980.

6. Protokolli për ndalimin e akteve të paligjshme të dhunës në aeroportet e shërbimit të aviacionit civil ndërkombëtar, i lidhur në Montreal, më 24 shkurt 1988.

7. Protokolli për ndalimin e akteve të paligjshme ndaj sigurisë së lundrimit detar, i lidhur në Romë, më 10 mars 1988.

8. Protokolli për ndalimin e akteve të paligjshme ndaj sigurisë së platformave të palëvizshme të bregut kontinental, i lidhur në Romë më 10 mars 1988.

9. Konventa ndërkombëtare për ndalimin e bombardimeve të terrorizmit, e miratuar në Nju-Jork, më 15 dhjetor 1997.

10. Konventa ndërkombëtare për ndalimin e financimit të terrorizmit, e miratuar në Nju-Jork, më 9 dhjetor 1999.